

VENDIM
Nr.89, datë 15.11.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANSARA KONCESION” SHPK

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “a”, 15 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ansara Koncesion” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e lejes mjedisore nga organet përkatëse është në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5, germa “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Ansara Koncesion” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Labinot - Mal - Elbasan”, me fuqi 0.25 MW me kusht që shoqëria “Ansara Koncesion” sh.p.k. të dorëzojë lejen mjedisore, brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta